



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborai Panel za žalbe i Predstavke**

**Anr.84/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga subjekti politik “FJALA” me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Këshillit për Operacione Zgjedhore, për shkak të mos emërimit të anëtarëve në listën e KVV-ve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.09.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** si i palejuar apeli Anr.84/2019 i datës 24.09.2019, i paraqitur nga subjekti politik “FJALA” me seli në Prishtinë.

## A r s y e t i m

Me datën 24.09.2019, subjekti politik “FJALA”, ka paraqitur apel në PZAP, në të cilin pretendohet se Këshilli për Operacione Zgjedhore me vendimin e tij në mënyrë të kundërligjshme i ka mohuar anëtarëve të subjektit në fjalë të drejtën për të nominuar anëtarët e tij në KVV, përkundër faktit se apeluesi i ka parashtruar dokumentacionin e nevojshëm konform dispozitave ligjore dhe kriterëve të përcaktuara. Me vendimin e Këshillit për Operacione Zgjedhore të datës 23.09.2019, subjektit politik “FJALA” është larguar nga listat e KVV-ve, në mënyrë të kundërligjshme pa sqaruar arsyet e largimit të këtij subjekti për të nominuar anëtarët e tij në KVV. Në fund ka propozuar që PZAP-i, të anuloi këtë vendim.

Parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve në apel si dëshmi ka bashkangjitur transkriptin e vendimit të SKQZ-së.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit gjeti se:

**Apeli është i palejuar,**

PZAP-i pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se apeli është i palejuar, pasi që parashtruesi i apelit ka atakuar vendimin e Këshillit për Operacione Zgjedhore, ndërsa me nenin 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, parashihet se PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së. Andaj në këtë rast meqenëse nuk ka vendim të KQZ-së, nuk është në juridiksionin e këtij institucioni për të vendosur për kërkesat e Këshillit për Operacione Zgjedhore.

Andaj, PZAP-i ,në mbështetje të dispozitës së nenit 118 par.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 84/2019 më datë 24.09.2019.

**Kryesuese e Panelit**  
**Gyltene Sylejmani**

**Këshillë juridike:** *PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*

